



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

**MBI ADMINISTRIMIN E LIKUIDITETIT NGA SHOQËRITË E SIGURIMIT DHE
RISIGURIMIT**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 56, datë 28.04.2016

Neni 1

Objekti

1. Kjo rregullore përcakton:

- a) Metodën e llogaritjes së normës së likuiditetit;
- b) Planin e masave dhe veprimeve në rast të mungesës së likuiditetit;
- c) Përmbytjen, mënyrën dhe afatet kohore për njoftimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha shoqëritë e licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe për degët e shoqërive të sigurimit të huaja, të cilat këtu e në poshtë në këtë rregullore do të quhen me termin e përbashkët “shoqëria e sigurimit”.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 84, pika 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Administrimi i likuiditetit

1. Shoqëria e sigurimit administron burimet financiare dhe investimet e saj në mënyrë të tillë që të sigurojë në çdo kohë përmbushjen e detyrimeve kur u vjen afati i pagesës.
2. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit, me qëllim mbrojtjen ndaj rrezikut të mungesës së likuiditetit miraton akte të brendshme për administrimin sistematik të likuiditetit, të cilat përfshijnë:
 - a) Politikat/strategjitë dhe procedurat e auditimit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit;
 - b) Organizimin;
 - c) Planifikimin e fluksit të parasë, të pritshëm dhe të mundshëm;
 - d) Strategjitë dhe politikat e administrimit të likuiditetit që përcaktojnë metodat e menaxhimit të likuiditetit të shoqërisë së sigurimit, në rrethana të zakonshme dhe të jashtëzakonshme;
 - e) Sistemin e përshtatshëm të menaxhimit të informacionit të përdorur për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e likuiditetit;
 - f) Planin e masave dhe procedurat për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të rrezikut të mungesës së likuiditetit.

Neni 4

Planifikimi i fluksit të parasë

1. Shoqëria e sigurimit duhet të planifikojë rregullisht fluksin e pritshëm, të njohur dhe të mundshëm të daljes së parave si dhe fluksin e mjaftueshëm të hyrjes së parave.
2. Për qëllim të monitorimit të likuiditetit, shoqëria e sigurimit do të planifikojë në fluksin e parasë në baza ditore, javore dhe mujore sipas mënyrës që plani i këtij fluksi monetar është bërë:
 - a) Për çdo ditë pune;
 - b) Për çdo ditë të parë të punës në një javë dhe duke ndjekur ditët e punës në vazhdim të së njëjtës javë;
 - c) Për çdo ditë të parë të punës të muajit duke ndjekur më pas ditët e punës në vazhdim përgjatë muajit.
3. Shoqëria e sigurimit duhet të ruajë në dokumentacionin e saj planin e flukseve të parasë, sipas parashikimeve të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 5

Metoda e llogaritjes së normës së likuiditetit

1. Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.
2. Aktivet likuide janë aktive në dispozicion të shoqërisë së sigurimit, të cilat përbëhen nga:
 - a) Gjendja në llogaritë rrjedhëse në banka;
 - b) Gjendja në arkë;
 - c) Depozitat pa afat, depozitat e garancisë për hua në bankë, me afat të mbetur maturimi deri në 7 ditë kalendarike dhe depozitat të cilat mund të tërhiqen brenda një periudhe (7)ditore;
 - d) Tituj financiarë apo aksione, të cilat mund të kthehen likuidë menjëherë, pra ato me maturitet deri (7) ditë kalendarike.
3. Detyrimet e shoqërisë së sigurimit të maturuara për pagesë janë detyrimet për kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, detyrimet për kontratat e risigurimit, detyrimet për komisionet, detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i investimeve, si edhe detyrime të tjera të cilat janë maturuar në ditën e llogaritjes së normës së likuiditetit.
4. Detyrimet e shoqërisë së sigurimit që maturohen së shpejti janë detyrimet për kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, detyrimet për kontratat e risigurimit, detyrimet për komisionet, detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i investimeve, si edhe detyrime të tjera që kanë afat maturimi deri në (7) ditë kalendarike ose që mund të tërhiqen në një periudhë (7) ditë kalendarike nga dita që llogaritet norma e likuiditetit.
5. Detyrimet e parashikuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, gjithashtu përfshijnë zëra të bilancit dhe zëra jashtë bilancit, të cilat nuk mund të tërhiqen por janë të lidhura me shpenzime apo detyrime nga kontratat e ardhshme dhe garancitë e dhëna.
6. Detyrimet e parashikuara në paragrafët 3 dhe 4, të këtij neni, gjithashtu përfshijnë shpenzimet e shtyra që nuk paraqiten si detyrime në bilanc, por që pritet të maturohen (1) ditë pas ditës që llogaritet norma e likuiditetit, duke mbajtur parasysh detyrimin përkatës.
7. Për qëllim të llogaritjes së normës së likuiditetit, aktivet likuide dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre duhet të pasqyrohen në vlerën kontabël.
8. Në llogaritjen e normës së likuiditetit, shoqëria e sigurimit nuk do të përfshijë në zërat e aktiveve likuide titujt e patregtueshëm dhe titujt për të cilët vendi i tregtimit nuk mund të përcaktohet.
9. Nuk konsiderohen si pjesë e aktiveve likuide titujt e klasifikuar si të mbajtura deri në maturim, me përjashtim të atyre që kanë patur apo kanë afat maturimi deri në (7) ditë kalendarike.

Neni 6
Niveli i mbajtjes së normës së likuiditetit

1. Shoqëria e sigurimit do të konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).
2. Shoqëria e sigurimit do të konsiderohet jolikuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje, është më i ulët se 1 (një).

Neni 7
Evidentimi dhe monitorimi ditor

1. Shoqëria e sigurimit do të llogarisë sipas të dhënave ditore këto elementë:
 - a) Vlerën e aktiveve likuide të përmendura në pikën 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje;
 - b) Nivelin e detyrimeve që janë maturuar sipas parashikimeve të pikave 3 deri 6 të nenit 5 të kësaj rregulloreje;
 - c) Normën e likuiditetit të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria e sigurimit duhet të llogarisë vlerën e aktiveve likuide, nivelin e detyrimeve që janë maturuar dhe normën e likuiditetit sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni duke përdorur Formularin 1.
3. Shoqëria e sigurimit duhet të plotësojë çdo ditë dhe të ruajë në dokumentacionin e saj Formularin 1, sipas të dhënave ditore.

Neni 8
Njoftim në rast mungese të likuiditetit

1. Në rast se evidentohet mungesë likuiditeti sipas parashikimeve të nenit 7, pika 2 të kësaj rregulloreje, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë Autoritetin për këtë fakt, jo më vonë se 24 orë pasi është zbuluar mungesa e likuiditetit.
2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni do të përfshijë gjithashtu shumën gjithsej, strukturën e aktiveve likuide dhe detyrimet e maturuara dhe të papaguara të shoqërisë së sigurimit, arsyet e paaftësisë për të kryer pagesat, si dhe masat e planifikuara dhe të ndërmarra, me qëllim eliminimin e paaftësisë së përkohshme për të kryer pagesat ose eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.
3. Gjithashtu, në njoftimin e përmendur në pikën 2, të këtij neni, shoqëria e sigurimit duhet të specifikojë në mënyrë të veçantë masat e ndërmarra ose detajet për burimin e aktiveve që

- janë ose që do të përdoren për të eliminuar mungesën e likuiditetit, si dhe për fluksin monetar të pritshëm dhe të mundshëm për muajin e ardhshëm.
4. Përveç njoftimit, shoqëria e sigurimit duhet gjithashtu të depozitojë përlogaritjen e normës së likuiditetit sipas Formularit 1, për datën në të cilën është konstatuar mungesa e likuiditetit.
 5. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, do të zbatohen nga drejtorët ekzekutivë të shoqërive të sigurimit.

Neni 9

Përmbajtja, mënyra dhe afatet e njoftimit

1. Shoqëria e sigurimit do të njoftojë Autoritetin për normën e likuiditetit, aktivet likuide dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre, për të gjitha ditët e punës së muajit të kaluar, duke përdorur Formularin 1.
2. Shoqëria e sigurimit duhet të paraqesë Formularin 1, të plotësuar në mënyrë të rregullt jo më vonë se 5 ditë pune pas ditës së fundit të muajit për të cilin është përgatitur Formulari 1.
3. Shoqëria e sigurimit duhet të paraqesë Formularin 1 pranë Autoritetit, në formë shkresore dhe elektronike.

Neni 10

Masat mbikëqyrëse

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në ligjin “Për sigurimet dhe risigurimet” si dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 3 muaj pas miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 12

Dispozitë e fundit

Formulari 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

FORMULAR 1

Emri i shoqërisë

Viti ushtrimor _____

Muaji _____

Llogaritja ditore e normës së likuiditetit

Nr.	Emërtimi	Shuma në datën
		(*)
		1
A	MJETE LIKUIDE (1+2+3+4+5+6+7)	0
1	Gjendja në llogaritë rrjedhëse në bankë, në Lekë	
2	Gjendja në llogaritë rrjedhëse në bankë, në valuta të huaja (EUR,USD,GBP)	
3	Gjendja në arkë	
4	Depozita bankare pa afat	
5	Depozitat e garancisë për hua në bankë, me afat të mbetur maturimi deri në 7 ditë	
6	Depozita me afat të cilat mund të tërhiqen në 7 ditët e ardhshme	
7	Letra me vlerë/aksione të cilat mund të kthehen likuide menjëherë, pra me afat maturimi deri në 7 ditë (7.1 deri në 7.3)	0
7.1	Të klasifikuara - të mbajtura deri në maturim	
7.2	Të klasifikuara – të vlefshme për shitje	
7.3	Të klasifikuara - me vlerën e tregut në llogarinë Fitime dhe humbje	
B	DETYRIME TË MATURUARA: (8+9+10+11+12+13+14+15)	0
8	Detyrime që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit(8.1 deri në 8.5)	0
8.1	Detyrime që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, të maturuara	
8.2	Detyrime që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, me afat maturimi deri në 5 ditë	
8.3	Detyrime për honorare dhe shpërblime, të maturuara	
8.4	Detyrime për komisionet e ndërmjetësimit me afatmaturimi deri në 7 ditë	
8.5	Detyrime të tjera nga veprimtaria direkte e sigurimit, të maturuara	
9	Detyrime nga aktiviteti i investimeve, të maturuara	
10	Detyrime nga aktiviteti i investimeve, me afat maturimi deri në 7 ditë	
11	Detyrime ndaj kreditorëve, të maturuara	
12	Detyrime ndaj kreditorëve, me afat maturimi deri në 7 ditë	
13	Detyrime ndaj punonjësve, të maturuara	
14	Detyrime ndaj punonjësve, me afat maturimi deri në 7 ditë	

15	Detyrime të tjera që janë maturuar ose kanë afat maturimi deri në 7 ditë	
16	Norma e likuiditetit (A/B)	0

Në vend të shenjës (*) vendoset data dhe muaji për të cilën llogaritet koeficienti.

P.sh. : 01.03. nëse norma e likuiditetit është për datën 1 mars

Vendi, data: _____

Përgatitur nga (emër, mbiemër): _____

Nënshkrimi : _____

Personi përgjegjës (emër, mbiemër): _____

Nënshkrimi : _____